

KARTELE INFORMATIVE

AL104028

1. Emri i shërbimit	Autorizim për statusin e eksportuesit të miratuar			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Statusi i eksportuesit të miratuar ka për qëllim lehtësimin e procedurave tregtare, pasi operatori ekonomik e deklaron vetë origjinën e produkteve, të cilat po i eksporton apo i ka eksportuar			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Statusi i eksportuesit të miratuar i mundësoni kompanisë vërtetimin e origjinës preferenciale të mallrave në eksport, nëpërmjet deklaratës-faturë/deklaratës-origjinë drejt vendeve, me të cilat Republika e Shqipërisë zbaton Marrëveshje të Tregtisë së Lirë si: vendet anëtare të Bashkimit Europian, vendet të CEFTA 2006, vendet të EFTA-s, Republikës së Turqisë, si edhe vendeve me të cilat mund të zbatohen marrëveshje ndërkombëtare në të ardhmen			
4. A jam përfitues?	Përfitues i këtij shërbimi është operatori ekonomik, i cili eksporton mallra me origjinë preferenciale drejt vendeve, me të cilat vendi ynë zbaton marrëveshje të tregtisë së lirë			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Formular aplikimi (aneks i miratuar)	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Po
	2	Karta teknologjike	Aplikanti	Po
	3	Fatura të lëndëve të para dhe ndihmëse	Aplikanti	Po
	4	(Foto, karta teknologjike, fatura, mostra, katalogë, etj.) që lidhen me produktin dhe procesin e prodhimit	Aplikanti	Po
	5	Ekstrakt	Qendra Kombëtare Biznesit	Jo
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Tiranë	Rruga "Dritan Hoxha", Laprakë, Tiranë 1001	E hënë - e premte, ora 08:00 - 16:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
	Ofrohet informacion mbi shërbimin	Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Shërbimi ofrohet tërësisht online
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	Shërbim pa pagesë			
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	60 ditë			
10. Çfarë përfitoj?	Formular autorizimi			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Pa afat			
12. Ku e marr?	Në sportele <input type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në:		Orari	
	E-albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPD web: www.dogana.gov.al Tel: 11800		Call Center: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input checked="" type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		<input checked="" type="checkbox"/>	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	<ul style="list-style-type: none"> MSA (Ligj Nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 87, datë 14 Gusht 2006). Neni 22 i Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të Origjinës (Ligj Nr. 1/2012, datë 26.01.2012, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 7, datë 20 Shkurt 2012) Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore CEFTA - 2006 (Ligj Nr. 9696, datë 21.3.2007, "Për ratifikimin e Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 37, datë 31.03.2007. Neni 22 i Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të Origjinës (Ligj Nr. 1/2012, datë 26.01.2012, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 7, datë 20 Shkurt 2012) Marrëveshja e Tregtisë së Lirë midis Republikës së Shqipërisë dhe Turqisë (Ligj Nr. 9733, datë 14.5.2007 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 66/1 datë 08.06.2007. Neni 23 - Protokoll II, Ligj Nr. 9733, datë 14.5.2007. Fletore Zyrtare Nr. 66/1 datë 08.06.2007 Marrëveshja e Tregtisë së Lirë midis Republikës së Shqipërisë dhe shteteve EFTA (Ligj Nr. 10288, datë 17.6.2010 Fletoren Zyrtare Nr. 91, datë 17.07.2010. Neni 22 i Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të Origjinës (Ligj Nr. 1/2012, datë 26.01.2012, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 7, datë 20 Shkurt 2012 Urdhër 09 datë 4.01.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave 			